

Bujqësia e Qëndrueshme

Në kuadër të Projektit JICA, në datën 8 Qershor, në fshatin Sulzotaj, u organizua trajnimi i tretë për promovimin e Bujqësisë së Qëndrueshme në territorin e Parkut Kombëtar Divjakë- Karavasta.



Profesorë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe ekspertë të bujqësisë ndanë njohuritë dhe eksperiencat e tyre tek fermerët e zonës për një bujqësi miqësore me mjedisin, si dhe parashtruan nevojën për përdorim sipas standardeve të inputeve bujqësore dhe vecanërisht nevojën për reduktimin e agrokimikateve.

Gjithashtu u diskutua mbi kërkesat dhe nevojat që kanë fermerët për kalimin nga bujqësia konvencionale në bujqësinë e qëndrueshme, të ndërgjegjshëm që praktikatat aktuale të bujqësisë ushtrojnë ndikim negative në cilësinë e ujërave dhe ekosistemin e Parkut Kombëtar Divjakë -Karavasta dhe botën e egër të këtij ekosistemi.



Punonjësit e Parkut



Adriatik Kaja punon pranë parkut si Ranger Mjedisor prej shumë vitesh tashmë.

Adriatiku është kontribues në ruajtjen e Florës dhe Faunës në zonën e parkut.

Ai angazhohet në ruajtjen e biodiversitetit, monitorimin e gjëndjes së mjedisit, monitorimin e aktiviteteve ekonomike dhe bashkëpunimet me komunitetin .

Eshtë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi reduktimin e ndotjes, degradimin dhe dëmin mjedisor, që përbëjnë rrezik të madh për natyrën dhe mjedisin.

Dëshira e madhe, për të parë parkun në gjëndje gjithnjë e më të mirë e inkurajon Adriatikut të vazhdojë aktivitetet e tij me të njëjtin ritëm si në ditët e para të punës.

BULETINI INFORMATIV

PER MUAJIN KORRIK 2022

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta



Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë
Tel: (+355) 69 890 0540
Email: dknpmmedia@hotmail.com

SCAN ME



Instagrami i
Projektit JICA

SCAN ME



Facebook
AdZM Fier

Monitorimi i Biodiversitetit

Në kuadër të projektit JICA sot u realizua Trajnimi mbi Monitorimin dhe Identifikimin e Llojeve Bimore në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta si pjesë e Monitorimit të Biodiversitetit.

Profesor i Universitetit të Tiranës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës Alfred Mullaj, realizoi një prezantim mbi Florën dhe Habitatet Bregdetare, Plazhet dhe Dunat Ranore për stafin e AdZM-së të cilët janë pjesë e Grupit të Punës për Biodiversitetin duke bërë më të thjeshtë identifikimin e llojeve bimore të rrezikuara sipas Librit të Kuq dhe Natura 2000 gjithashtu edhe specieve më të rëndësishme të gjendura në zonë, për të ditur rëndësisë e dunave ranore dhe njohjen me tipet e habitateve natyrore.

Pas prezantimit të gjithë pjesmarrësit vazhduan trajnimin në terren duke bërë monitorimin e llojeve të ndryshme bimore të gjendura në bregdetin e Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta.

Të tilla trajnime do të vazhdojnë edhe më tej për stafin e AdZM për përmirësimin e njohurive në identifikimin dhe monitorimin e florës dhe habitateve bregdetare.



Peshkimi i Qëndrueshëm

AdZM Fier në bashkëpunim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit "Laguna e Karavastës" dhe mbështetjen e Projektit po zbaton aktivitetin e Markimit dhe Rikapjes së Qefullit.

Teknikat e markimit dhe rikapjes kanë një histori të gjatë studimesh në biologjinë e kafshëve të egra dhe të peshkimit, pasi ajo përdoret për të vlerësuar madhësinë e populatave, gjithashtu mbijetesën dhe rritjen e saj.

Siç nënkupton edhe emri i teknikës, individët e një popullete kapen duke përdorur një metodë kampionimi dhe shënohen në rastin tonë përmes fjongove me ngjyrë.

Këta individë të shënuar, lëshohen përsëri në ujë me mundësinë për tu rikapur më vonë nga peshkarët. Informacioni do të përdoret për të vlerësuar madhësinë e popullates



Vizitorë të Parkut

Studentë të ndryshëm nga e gjithë Shqipëria dhe jo vetëm organizojnë vizita studimore në formën e ekspeditave në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta.



Specialistët e Menaxhimit së bashku me profesorët e tyre prezantojnë përpara studentëve vlerat e parkut dhe rëndësinë e tij në ekosistem.

Studentët e fakulteteve të Shkencave të Natyrës janë më të interesuarit për shkak të diversitetit të florës dhe faunës së gjendur pranë parkut.

Nuk mungojnë edhe studentët nga vende të ndryshme të botës ku në qëndër të vizitave të tyre kanë parkun e Divjakës për të zhvilluar praktikën e lëndëve të tyre mësimore.

